



# Universiteti i Prishtinës

UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381-38-244183

Fax: +381-38-244187

URL: <http://www.uni-pr.edu>

Mail: [rektorati@uni-pr.edu](mailto:rektorati@uni-pr.edu)

Nr. Prot.: 21178

Datë: 23.7.2019

Mbështetur në nenin 17 të Kodit të Etikës për stafin akademik të Universitetit të Prishtinës (Nr. 1/751, dt. 19/07/2013), sidomos dispozitave të neneve 6, 7 dhe 8 të Rregullores për Masat dhe Procedurat Disiplinore ndaj Personelit Akademik të Universitetit të Prishtinës dhe Rregulloren e Punës të Këshillit të Etikës (Nr. 1/629, dt. 14/07/2016), Statutin e Universitetit të Prishtinës, Ligjit të Punës si dhe duke ju referuar vendimit nr. 703 të datës 17/03/2017 të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, Këshilli i Etikës, në mbledhjen e mbajtur me datën 17.07.2019 mori këtë:

## VENDIM

- I. Prof. ass. dr. Ilir Shehu, mësimdhënës në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore, Departamenti i Kimisë, i shqiptohet masa ndëshkuese “vërejte me shkrim” në bazë të nenit 8, paragrafi 1, pika 1.2, e Rregullores nr. 857 për Masat dhe Procedurat Disiplinore Ndaj Personelit Akademik të UP-së për shkelje disiplinore të rënda nga neni 6, paragrafi 1, pikat 1.18 dhe 1.22.
- II. Shkelje e rëndë e zbatueshme në këtë rast është “kryerja e aktiviteteve që bien ndesh me interesat e institucionit apo veprimet që e dëmtojnë institucionin” dhe “keqpërdorimi i autoritetit dhe emrit të universitetit për përfitime personale jashtë universitetit” sipas nenit 6, pikat 1.18 dhe 1.22, e Rregullores nr. 857, dt. 11.04.2017, si rezultat i paraqitjes së të denoncuarit në mënyrë të pavërtetë si Prodekan i FSHMN-së për përfitime personale jashtë universitetit, duke insistuar nga një revistë e huaj heqjen e një punimi të publikuar në atë revistë.
- III. Masa “vërejtje me shkrim” për shkelje disiplinore i shqiptohet si masë ndëshkuese sipas nenit 8, pika 1.2, të Rregullores nr. 857, dt. 11.04.2017.
- IV. Vërejtja me shkrim do t’i drejtohet palës së denoncuar nga ana e Rektorit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina’.
- V. Këshilli i Etikes e ka shqyrtuar rastin me kujdesin e duhur dhe konsideron se me këtë rast vendos Këshilli i Etikes dhe nuk është e nevojshme të vendosë Senati, meqë janë marrë në konsideratë rrethanat lehtësuese (pranimin e sjelljes apo veprimit nga ana e të denoncuarit) lidhur me çështjen.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

*Ilir Shehu*

## Arsyetim

### **Paraqitja, vlerësimi dhe kualifikimi i të gjeturave faktike**

- Me datë 14.09.2018, OJQ ORCA (Organizata për Rritjen e Cilësisë) i ka drejtuar Këshillit të Etikës një denoncim për shkelje të supozuar nga prof. ass. dr. Ilir Shehu, nga FSHMN Departamenti i Kimisë.
- Denoncimi ka të bëjë me faktin se, me datë 27 prill 2018, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” ka shpallur konkurs publik për zgjedhjen e personelit akademik, në të cilin prof. ass. dr. Ilir Shehu ka aplikuar për t’u avancuar në pozitën e profesorit të asocuar, me ç’rast ka marrë vlerësim pozitiv nga ana e Komisionit Vlerësues.
- Prof. ass. dr. Ilir Shehu ka publikuar pesë punime në revistën “*International Journal of Sciences Review and Resarsh*”, e cila revistë është e dyshimtë, Senati i UP-së në mbledhjen e mbajtur me datë 10.09.2018 ka marrë vendim për heqjen nga lista e vlerësimeve të punimeve, revistën “*International Journal of Pharmaceutical Sciences Review and Research*”, që ta fusë këtë revistë në listën e revistave të dyshimta, në të cilën kishin publikuar artikuj “shkencorë” persona fiktiv si “*Rrush Kalaveshi*” të një personi anonim i cili ishte paraqitur si pjesë e personelit akademik të një universiteti fiktiv “*Universiteti i Ranillukut*” (komunë e banuar me shumicë të komunitetit serb, në afërsi të Gjilanit). Prandaj, kjo revistë nuk mund të merret si revistë valide për zgjedhje, rizgjedhje apo avancimet e personelit akademik. Senati i UP-së, duke parë që një revistë e tillë nuk bën kurrfarë redaktimi paraprak, ka vendosur që të marrë masa dhe të përjashtojë nga përllogaritja punimet e publikuara në këtë revistë dhe i ka kthyer kandidatët sipas procedurave në Këshill të Fakultetit.
- Prof. ass. dr. Ilir Shehu, me datë 9 shtator 2018, duke u paraqitur në mënyrë të pavërtetë se është Prodekan i FSHMN-së, i ka shkruar email revistës “*International Journal of Pharmaceutical Sciences Review and Research*”, dhe ka kërkuar nga revista që ta tërheq punimin “shkencor” të “*Rrush Kalaveshi*” meqë ky i fundit është një person fiktiv, punimi i tij nuk ka asnjë vlerë shkencore dhe si pasojë e veprimeve të tij po dëmtohen shumë profesorë nga FSHMN-ja që kanë bërë publikime në këtë revistë, ku profesori në fjalë shkon edhe me tej duke e paralajmëruar revistën se nëse kjo e fundit nuk e tërheqë punimin “*Rrush Kalaveshi*”, atëherë do të lajmërohet revista si e dyshimtë në të gjitha bazat e të dhënave shkencore. Prandaj, i sugjeron revistës që të bashkëpunojë me të, meqë sipas tij bashkëpunimi është në interesin e të dyja palëve.
- Këshilli i Etikes e ka shqyrtuar rastin me kujdesin e duhur dhe konsideron se më këtë rast merret vetë Këshilli i Etikes dhe nuk është e nevojshme të vendosë Senati.




- Këshilli i Etikës është marrë seriozisht me këto pretendime dhe me denoncimin e paraqitur. Konform rregullave përkatëse juridike, është zhvilluar procedura: fillimisht me komunikimin e shkresave tek i denoncuari për të vazhduar me komunikim të nevojshëm nëpërmjet shkresave.
- Këshilli i Etikës ka zhvilluar seancën dëgjimore duke u bazuar në kuadrin normativ përkatës dhe duke pasur në konsideratë praktikën e krijuar para këtij Këshilli me dedikimin për trajtim të gjithanshëm dhe të drejtë të secilit rast të procesuar për të arritur tek e vërteta materiale.
- Në seancën dëgjimore janë dëgjuar dekani i FSHMN-së prof. dr. Tahir Arbneshi, dhe prof. ass. dr. Ilir Shehu. Dekani prof. dr. Tahir Arbneshi deklaroi se prof. ass. dr. Ilir Shehu nuk ka qenë prodekan asnjëherë në FSHMN. Dekani Arbneshi ka deklaruar se ka dëgjuar për rastin, por se nuk është informuar institucionalisht dhe për pasojë ky rast, pavarësisht seriozitetit, nuk është paraqitur dhe shqyrtuar nga menaxhmenti apo organet e tjera të FSHMN-së.
- Pala e denoncuar, prof. ass. dr. Ilir Shehu, ka paraqitur po ashtu qëndrimin e tij, duke mos mohuar faktet e prezantuara, por duke mos pasur ndjenjën e të vepruarit në mënyrë kundër statutare, e aq më pak të vepruarit kundër normave etike. I denoncuari ka pranuar se i ka dërguar email revistës “*International Journal of Pharmaceutical Sciences Review and Research*”, duke paraqitur rrejtshëm pozitën e tij se kinse është Prodekan i FSHMN-së dhe nga ky funksion i paqenë i ka kërkuar revistës që të heqë punimin e “*Rrush Kalaveshi*”, me deklarin, që në thelb mund të kualifikohet si kërcënim, se në të kundërtën do ta paraqesë revistën si të dyshimtë në të gjitha bazat e të dhënave shkencore. Prof. ass. dr. Ilir Shehu e ka justifikuar veprimin e tij me qëllimin e vetëm që të gjejë se kush është autori i vërtetë ose emri i vërtetë i prezantuar si “*Rrush Kalaveshi*”. Në këtë kontekst, Këshilli nuk sheh se cili është ose mund të ketë qenë interesi publik ose interesi i përgjithshëm institucional. Në të vërtetë, po të kishte një interes të tillë, Universiteti, sikundër dhe njësitë e tij akademike, kanë autoritetet e zgjedhura institucionale që kanë detyrim të mbrojnë dhe përfaqësojnë interesin institucional.
- Këshilli i Etikës e ka trajtuar me kujdes të plotë këtë lëndë dhe ka arritur në përfundimin se prof. ass. dr. Ilir Shehu ka keqpërdorur autoritetin dhe emrin e universitetit—duke u prezantuar në mënyrë të pavërtetë si Prodekan i FSHMN-së—për përfitime personale jashtë universitetit dhe duhet t’i shqiptohet masa për shkelje disiplinore sipas Rregullores për Masat dhe Procedurat Disiplinore Ndaj Personelit Akademik të UP-së (Rregullorja me nr. 857, dt. 11.04.2017). Një sjellje e tillë qartazi bie nën standardin e kërkuar të sjelljes dhe integritetit të lartë të personelit akademik. Sjellja e tillë cenon Rregulloren nr. 857 për Masat dhe Procedurat Disiplinore Ndaj Personelit Akademik të UP-së, më saktësisht nenin 6, pika 1.22, e cila ka këtë përmbajtje: “Keqpërdorimi i autoritetit dhe emrit të universitetit për

përfitime personale jashtë universitetit”, si dhe pika 1.18 e nenit 6: “Kryerja e aktiviteteve që bien ndesh me interesat e institucionit apo veprimet që e dëmtojnë institucionin”.

- Duke marrë për bazë të gjitha rrethanat e rastit, në tërësinë e tyre faktike dhe ligjore, dhe në veçanti Kompetencat e Këshillit të Etikës, Këshilli ka vendosur me shumicë votash si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Për dhe në emër të Këshillit të Etikës



Prof. Dr. Iset Morina  
Kryetar